

VENDIM
Nr.29, datë 4.5.2007

PËR VENDOSJEN E GJOBËS KESH SHA

Në mbështetje të neneve 9, 64, pika 1 germa “c” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e datës 4.5.2007, mbasi konstatoi moszbatimin e vendimit nr.62, datë 3.10.2006 “Për përcaktimin e kohëzgjatjes së periudhës transitore dhe të sasisë së faturimit aforfe për klientët familjarë që nuk janë të pajisur me matës të energjisë elektrike”

VENDOSI:

1. Vendosjen e gjobës për KESH sh.a. në masën 300 000 lekë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta